22100	Transfere për qeveri tjera	25,089.00	-	25,089.00	#DIV/0!
22202	Transfere për përfitues individual tjerë	-	800.00	-800.00	- 100.00
	Totali në subvencione dhe transfere	25,089.00	800.00	24,289.00	3,036.13

Tabela 9 – Ekzekutimi i Subvencioneve dhe Transfereve

22100 – Transfere për Qeveri tjera – Ekzekutimi i shumës 25,089.00 € nga ky kod ekonomik ka të bëjë me transferin e një pjese të Donacionit nga Unioni Evropian në Institucionet partnere nga Maqedonia e Veriut.

3.7 KATEGORIA SHPENZIME KAPITALE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

Analiza e të dhënave financiare të këtij raporti tregon se gjatë tremujorit të parë të vitit fiskal 2026, nuk ka shënuar asnjë shpenzim. Poashtu edhe në vitin paraprak 2025 përgjatë periudhës së njejtë, nuk ka pasur shpenzim.

REPubLIKA E KOSOVËS
REPubLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY
HANI ELEZIT

Nr. i Prot. 04/3370
Nr. i Faq. 1 Data 14.04.26



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



04/Nr. 3370 /2026

DATA:	14.04.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendi Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i komunës së Hanit të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi <i>L. Ballazhi</i> Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Raporti i progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të vitit 2024



I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar Anëtarë të Kuvendit,

Përmes kësaj shkrese, duke u bazuar në Nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, Komuna e Hanit të Elezit ka përgatitur Raportin e progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të vitit 2024 të dalura nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Me respekt,

Raporti i progresit të zbatimit të rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024

Nr	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra	Zyrtari/ët përgjegjës / Drejtoria	Statusi i gjetjes	Komente
1	Çështja B1 – Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga Thesari	<p>Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMPPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmba ruesi.</p> <p>Në tri raste në vlerë 24,931.4€, kemi identifikuar vonesa në ekzekutimin e faturave/obligi</p>	Kryetari duhet të forcoj kontrollin në menaxhimin e obligimeve dhe menaxhimin e tyre, duke siguruar fonde të mjaftueshme si dhe pagesën me kohë të faturave, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.	Është shtuar kontrolli në ekzekutimin e pagesave në afatin e paraparë Ligjor, përveç lëndëve nga Kontrata Kolektive të cilat i ekzekuton Thesari pa paralajmërim	Drejtoria për Buxhet dhe Financa Drejtoritë tjera të cilat krijojnë obligime	Pjesërisht e zbatuar	Arsyeja e disa vonesave në ekzekutimin e obligimeve financiare është si pasojë e ekzekutimit të mjeteve drejtpërdrejt nga Thesari (Kontrata Kolektive), me ç'rast kemi mbetur pa mjete në një Nën-Program dhe kategori buxhetore ku edhe është krijuar obligimi i rregullt financiar.

		<p>meve kontraktuale përtej afatit të përcaktuar. Vonesat ishin nga 14 deri 284 ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 ditëve.</p> <p>Gjithashtu, bazuar në mostrat të pagesave prej 27,791€ si rezultat i procedurave përmbare dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesën me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, si dhe obligimeve nga kontrata kolektive për personelin arsimor, në emër të kamatave, tarifave të përmbaremit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore, janë paguar kosto shtesë në vlerë 11,182€.</p>					
2	Çështja A1 – Keqklasifikimi i shpenzimeve	Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i	Në rastet prej të cilat ka rezultuar kjo e gjetur si OB nuk kemi përgjegjësi se mjetet janë ekzekutuar drejtpërdrejt nga Thesari pa paralajmërim.	Drejtoria e Financave,	Pjesërisht e zbatuar	OB-ja në rastet e gjetura nuk është përgjegjëse pasi që Thesari i ekzekuton shumicën e lëndëve pa

	<p>adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Në dy (2) raste të pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendimet përmbare në vlerën 27,791€, shpenzimet që për nga natyra e i takojnë pagave dhe mëditjeve, janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale. Këto shpenzime kishin të bëjnë për obligimet e kontratës kolektive për paga jubilarë dhe shujta, për punonjësit e arsimit. Kjo ka rezultuar në mbivlerësimin financiar të shpenzimeve të kategorisë së</p>	<p>kategorive dhe kodeve përkatëse dhe në përputhje me planin kontabël të Thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.</p>	<p>Megjithatë, për obligime tjera të cilat krijohen do të shtohet kontrolli që këto obligime të ekzekutohen në përputhje me planifikimet buxhetore dhe kodet ekonomike përkatëse.</p>			<p>paralajmërim dhe pa aprovimin tonë paraprak. Kemi bërë kërkesa në Thesar që kur të pranohen për ekzekutim lëndët nga Gjykata apo Përmbare e të na njoftojnë dhe të marrin aprovimin tonë për linjat buxhetore, në mënyrë që më tutje mos kemi implikime financiare.</p>
--	--	--	---	--	--	--

		<p>investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e kategorisë së paga dhe mëditje. Kjo ka ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të buxhetit për detyrimet e mundshme në kategorinë përkatëse ekonomike.</p>					
3	Çështja B2 – Nënvlërësim i regjistrimit të pasurisë në PFV	<p>Neni 6, paragrafi 3 i Rregullores 02/2023 për menaxhimin e pasurive jo financiare në Organizatat Buxhetore përcakton që: Pasuria kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale duhet të regjistrohet në sistemin E-pasuria. Poashtu, neni 11, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores përcakton se pasuritë jofinanciare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.</p>	<p>Është shtuar kontrolli i regjistrimit të pasurive</p>	<p>Drejtorja e Administratës, Drejtorja për Buxhet dhe Financa</p>	E zbatuar	-

	<p>kategorinë e investimeve në vijim dhe nuk zhvlerësohen. Pasuritë e prezantuara në PFV ishin nënvlerësuar për 177,172 € për shkak se investimet e paguara gjatë vitit 2024 për ndërtimin e rrugëve, trotuareve, kanalizimeve, infrastrukturës shkollore etj nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale në SIMFK-së. Pasuri në vlerë 139,172 € ishin projekte të përfunduara dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim, derisa pasuri në vlerë 38,000 €, ishin pagesa për projekte që nuk kanë përfunduar dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në vijim.</p>					
--	---	--	--	--	--	--

4	Çështja B3 – Të arkëtueshmet	Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme me nr. 06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) €. Sipas nenit 27, të ligjit të njejtë, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se (10) ditë	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes marrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese.	Do të shtohet kontrolli në inkasimin e të hyrave.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Inspeksionit	Pjesërisht e zbatuar	Janë bërë njoftime për afatet e pagesave, janë ofruar lidhje të marrëveshjeve për pagesë me këste të obligimeve si dhe janë ndërmarrur edhe masa tjera ligjore.
---	------------------------------	--	--	---	---	----------------------	---

		<p>kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.</p> <p>Komuna ka shpalosur në PFV 2024, llogari të arkëtueshme në vlerë totale 515,775 . Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje dhe në krahasim me vitin paraprak rritja e tyre është 162,757 €. Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga tatimi në pronë.</p>					
5	Çështja B4 – Mos themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm	<p>Rregulloren QRK Nr 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi tre (3) milion euro themelon Njesisë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë së paku dy auditor.</p> <p>Komuna Hani i Elezit edhe pse në vitin 2024</p>	Kryetari duhet të marrë veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohësisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Do të ri-përsërimin kërkesat tona si OB për aprovim të numrit të stafit sepse momentalisht nuk kemi pozita të lira në Administratë Komunale.	Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	E pazbatuar	Kemi bërë kërkesa në MFPT për aprovim të një numri të caktuar të stafit për të cilat ka nevojë Komuna.

		kishte buxhet mbi 4 milion euro, ndërsa nuk e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, siç kërkohet me rregullën përkatëse.					
--	--	--	--	--	--	--	--



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/nr. 3406 /2026

DATA	14.04.2026
PËR	KPF dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES	Mehmet Ballazhi Kryetari i Komunës <i>M Ballazhi</i>
NGA	Hisni Luri Drejtor për Arsim <i>Hisni Luri</i>
LËNDA	Informatë mbi raportin e Komisionit për ndarjen e bursave për vitin shkollor 2025/26

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale me Nr. 03/ L-040, Neni 11 dhe 12.1, Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, Neni 63 dhe në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. 01/ 8214/ 2024 të datës 04.10.2024 dhe në thirrjen e shpallur nga DKA-ja të datës 09.02.2026, ju dërgojmë informatën për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentët e Komunës së Hanit të Elezit për vitin shkollor 2025/2026.

Me respekt

RAPORT I NDARJES SË BURSAVE PËR STUDENT PËR VITIN AKADEMIK 2025/2026

Komuna Hani i Elezit përkatësisht Drejtoria për Arsim, bëri thirrjen publike për aplikim e bursave për studentë për vitin shkollor 2025/2026.

Pas përfundimit të thirrjes, formohet komisioni për ndarjen e bursës për studentët që kanë aplikuar për fitimin e bursës në vitin shkollor 2025/2026, në thirrjen e shpallur nga Drejtoria për Arsim.

Komisioni:

1. Sear Dernjani - Kryesues i komisionit
2. Avni Bushi - anëtar
3. Betime Dernjani - anëtare
4. Vahit Qupi - anëtar
5. Sevime Bajrami - anëtare

Komisioni ka shqyrtuar dhe ka hartuar listën, të radhitur sipas pikëve, të cilën listë e kemi publikuar më datën më 07.04.2026

Ne si drejtori bazuar në rregulloren e ndarjes së bursave këtë vit kemi ndarë 51 bursa në shumën prej 500€ për student, duke përfshirë edhe studentët nga Republika e Maqedonisë Veriore.

Aplikantët (studentët) që kishin aplikuar për bursa gjithësej ishin (68), ndërsa 51 nga ta janë përfitues të bursës, nga kjo janë 36 vajza dhe 15 djem, ku përfitues kanë qenë edhe student nga viti i parë.

Këtë informatë e japim deri me këtë date 14.04.2026, mbase informatën përfundimtare do të ua japim pas afatit të shqyrtimit të ankesave.

Të bashkangjitur e keni edhe listen e plotë dhe pikët për secilin student.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit

05/ 3171 /2026
Data 07/04/2026

Lista e studentëve përfitues për bursa komunale për vitin akademik 2025/26

Nr	Emri	Emri i Prindit	Mbiemri	Fakulteti	Viti i studimeve	Nota mesatare	Pikët totale
1.	Albin	Sabedin	Bajramaliu	Fakulteti i Mjekësisë	VI	9.47	77.35
2.	Mevlane	Avdush	Thaçi	Fakulteti i Mjekësisë	III	9.24	76.20
3.	Juleda	Nazim	Dernjani	Fakulteti i Mjekësisë	III	9.23	76.15
4.	Aldin	Sabedin	Bajramali	Fakulteti i Mjekësisë	IV	8.85	69.25
5.	Lejla	Zejnulla	Bela	USHA-Ferizaj	II	8.64	68.20
6.	Melisa	Bujar	Ballazhi	Fakulteti i Edukimit	II	8.64	68.20
7.	Medina	Nuhi	Axhami	USHA-Ferizaj	II	8.56	67.80
8.	Furkan	Imer	Hasallari	USHA-Ferizaj	III	8.52	67.60
9.	Ajla	Izet	Dernjani	Fakulteti Filozofik	III	8.52	67.60
10.	Ariana	Mevludin	Kuka	Fakulteti i Filologjik	II	8.45	67.25
11.	Albulena	Avni	Shiti	FSHMN-Biokomi	III	8.35	66.75
12.	Sumeja	Servet	Meliqi	Fakulteti i Mjekësisë	II	8.33	66.65
13.	Qendresa	Zekrija	Shkreta	Fakulteti i Edukimit	III	8.31	66.55
14.	Shkurte	Zequirja	Kuka	USHA-Ferizaj	III	8.31	66.55
15.	Betim	Qamil	Kalisi	Fakulteti i Mjekësisë	V	8.29	66.45
16.	Ajsun	Ferid	Dernjani	FSHMN-Biokomi	II	8.00	65.00
17.	Sumeja	Ramadan	Loku	Fakulteti i Edukimit	III	9.00	65.00
18.	Mirditë	Mevludin	Kuka	Fakulteti i Edukimit	II	8.93	59.65
19.	Aida	Zekirja	Shkreta	USHA-Ferizaj	III	8.39	56.95
20.	Valton	Xhevahir	Dernjani	USHA-Ferizaj	II	8.35	56.75
21.	Arjeta	Muharem	Rogaçi	Fakulteti Filozofik	II	8.00	55.00
22.	Drilon	Azem	Bushi	Fakulteti i Mjekësisë	V	6.84	54.20
23.	Drita	Mexhit	Dernjani	Fakulteti Ekonomik	III	7.83	54.15
24.	Erblin	Basri	Maliçi	Fakulteti i Mjekësisë	VI	7.78	53.90
25.	Emir	Fadil	Dernjani	Fakulteti i Mjekësisë	V	7.65	53.25
26.	Fatime	Halit	Luri	USHA-Ferizaj	III	7.64	53.20
27.	Bleona	Agim	Sopa	Fakulteti i Mjekësisë	VI	7.59	52.95
28.	Albin	Bafti	Bajrami	USHA-Ferizaj	II	7.54	52.70
29.	Lavdrim	Sheval	Thaçi	Fakulteti Inxhinerisë	III	7.38	51.90
30.	Linda	Muhamet	Topojani	Fakulteti Inxhinerisë	III	7.08	50.40
31.	Lejla	Ibrahim	Laçi	USHA-Ferizaj	II	7.86	44.30
32.	Alena	Setki	Hasallari	USHA-Ferizaj	III	7.85	44.25
33.	Ajferë	Izet	Curri	USHA-Ferizaj	II	6.78	43.90
34.	Ensar	Tahir	Brava	USHA-Ferizaj	II	6.67	43.35
35.	Urata	Agim	Vila	Fakulteti Ekonomik	II	7.64	43.20

36.	Erion	Besim	Bushi	Fakulteti Inxhinerisë	II	6.57	42.85
37.	Alma	Nusret	Xhoni	Fakulteti Ekonomik	III	7.45	42.25
38.	Elmedina	Ramiz	Laqi	Fakulteti Filozofik	III	7.39	41.95
39.	Sherif	Qenan	Kalisi	USHA-Ferizaj	III	7.00	40.00
40.	Lindita	Ibrahim	Luri	USHA-Ferizaj	III	7.32	36.60
41.	Eriola	Sadat	Kuka	USHA-Ferizaj	III	6.79	33.95
42.	Fationa	Amet	Ballazhi	Fakulteti i Mjekësisë	I		88
43.	Suela	Mahi	Ballazhi	Fakulteti i Mjekësisë	I		84
44.	Suela	Faredin	Qajani	Fakulteti i Edukimit	I		82
45.	Erda	Nehat	Xhoni	Fakulteti i Edukimit	I		80
46.	Jehona	Isuf	Shiti	Fakulteti Filozofik	I		70
47.	Albina	Ganimete	Kalisi	Fakulteti Filozofik	I		69
48.	Ermira	Ali	Berisha	Fakulteti i Mjekësisë	I		66
49.	Sumeja	Nazim	Dernjani	Fakulteti Ekonomik	I		66
50.	Jeta	Rexhep	Bushi	FSHMN-Biologji	I		65
51.	Xhemal	Servet	Suma	Fakulteti Inxhinerisë	I		65

Këshillë Juridike: Në bazë të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve nr.01/8214/2024, neni 9, aplikantët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në afat prej 5 ditë pune, te Komisioni i Ankesave.

Komisioni vlerësues:

1. Sear Dernjani
2. Avni Bushi
3. Sevime Bajrami
4. Vahit Qupi
5. Betime Dernjani





Republika e Kosovës – Republic of Kosova
Ndërmarrja Publike Lokale
“PASTRIMI”SH.A
Hani Elezit



01/Nr. 3407/2026

Data:	14.04.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES:	Kryesuese e Komisionit të Aksionerëve – Sevime Bajrami
NGA:	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL "PASTRIMI" SH.A
LËNDA:	Informatë mbi Raportin për periudhën Janar – Mars /2026



Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Me anë të kësaj shkrese po ua përcjelli raportin për periudhën janar - mars /2026 të Ndërmarrjes Publike Lokale të Mbeturinave - NPL "Pastrimi" Sh.a.

Me respekt,

RAPORTI PËR PERIUDHËN JANAR – MARS / 2026, I NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE TË MBETURINAVE - NPL "PASTRIMI" SH.A

Ky raport është përgatitur për periudhën Janar – Mars / 2026, në bazë të ligjit për Ndërmarrjet Publike - Ligjit Nr.03/L-087, të nenit 31 dhe nenit 14, paragrafit 14.2 dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a.

Ndërmarrja Publike Lokale – NPL "PASTRIMI" SH.A, bënë menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, ku përfshihen të gjitha lokalitetet e Komunës.

Ndërmarrja Publike Lokale – Npl "Pastrimi" Sh.a, ka gjithësej tetëmbëdhjetë (18) punëtorë :-

- 1 Kryeshef Ekzekutiv
- 1 Sekretar i Ndërmarrjes
- 1 Arkëtare (ushtruese detyre e ZKF –së)
- 1 Inkasant
- 3 Shofer
- 5 Punëtor teknik
- 6 Pastrues (Grumbullues të mbeturinave)

Sa i përket kësaj periudhe Janar – Mars 2026, mund të themi se gjatë kësaj periudhe ka qenë një periudhë me mjaft aktivitete nga punëtorët e ndërmarrjes publike lokale "Pastrimi". Gjatë kësaj periudhe punëtorët e kompanisë kanë qenë të angazhuar në teren në kryerjen e shërbimit të mbeturinave, kanë bërë pastrimin e borës dhe hudhjen e kripës gjatë sezonës së dimrit dhe njëkohësisht kanë kryer pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në qendër të Hanit të Elezit, pastrimin e rrugëve në fshatra përreth, pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve në Pustenik, pastrimin dhe mirëmbajtjen e parkut të qytetit "Isa Berisha", krasitjen e pemëve dekorative në qendër të Hanit të Elezit.

Gjatë kësaj periudhe Janar-Mars 2026 janë realizuar të hyra më shumë se sa vitin e kaluar po të njejtës periudhë Janar-Mars 2025, ku në vazhdimësi e keni tabelën përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve.

Gjatë periudhës Janar –Mars / 2026, është mbajtur një (1) mbledhje me Bordin e Drejtorëve të Npl "Pastrimi" Sh.a. për arsye se nuk kanë qenë ende të përzgjedhur anëtarët e Bordit dhe se mbledhja e parë është mbajtur në muajin Mars me rastin e përzgjedhjes së tyre.

Lista e punëtorëve të NPL-së, pozita e vendit të punës dhe paga e tyre si vijon:-

Nr.	Pozita	Nr. Punëtorëve	Paga Bruto
1	Kryeshefi Ekzekutiv	1	957.00
2	Sekretar i Ndërmarrjes	1	568.21
3	Arkëtare	1	568.21
5	Shofer	2	512.84
6	Shofer – mbykqyres i punëtorve në teren	1	568.21
7	Inkasant	1	512.84
8	Grumbullues i mbeturinave	6	447.35
9	Punëtor teknik	5	447.35
	TOTALI I STAFIT TË NPL-SË	18	

Çmimoret e kontratave janë:

- Kontratë familjare **6.50 €** në muaj,
- Kontratë e mesme **10.40 €** në muaj,
- Kontratë me zbrazje **16.90 €** për çdo zbrazje të kontenjerit **1100L**.

Gjatë periudhës Janar – Mars / 2026 janë nënshkruar disa kontrata me klient të rinj të Npl"Pastrimi" Sh.a, ato janë:

- Kontratë familjare **1**
- Kontratë biznesore **0**
- Institucionale **0**

Totali i kontratave të nënshkuara nga viti 2017 – Mars / 2026 janë si vijon:

- **Ekonomitë familjare ----- 1342**
- **Kontratë biznesore ----- 116**
- **Kontratë institucionale ----- 11**
- **Totali i kontratave ----- 1469**

1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të nenit 14, paragrafët 14.2 si dhe statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale.

Ky raport përmban një përmbledhje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore të kompanisë së mbeturinave përgjatë periudhës Janar –Mars 2026. Raporti pasqyron të hyrat e kompanisë, si dhe krahasimet me periudhën paraprake.

Performanca e të hyrave nga shërbimet

Të hyrat nga shërbimet në periudhën raportuese Janar –Mars 2026 kanë arritur vlerën 70,841.43 euro duke shënuar trende rritëse me 5.03% që korrespondon me 3,395.46 euro më shumë krahasuar me të hyrat e të njëjtës periudhe të vitit 2025.

Performanca e shpenzimeve të kompanisë

Shpenzimet e kompanisë në periudhën raportuese kanë arritur vlerën prej 72,041.43 euro duke shënuar një rritje prej 6.10 % që korrespondon me 4,142.66 euro më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

- **Shpenzimet për paga dhe mëditje** në periudhën raportuese shënuan vlerën e 35,215.22 € duke shënuar një rritje prej 5,466.02 € apo 18.37% krahasuar me vitin 2025.
- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** në periudhën raportuese shënuan vlerën prej 21,710.07 € duke shënuar një rënie prej 1,078.43 € apo 4.73 % krahasuar me vitin 2025.

A. TË HYRAT

A	TE HYRAT	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	67,445.97	70,841.43	3,395.46	5.03%
2	Te hyra tjera	452.80	1,200.00	747.20	165.02%
	TOTALI	67,898.77	72,041.43	4,142.66	6.10%

B. PAGA DHE MEDITJE

B	PAGAT DHE MEDITJET	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	PAGAT NETO + SHUJTA	25,976.45	30,621.14	4,644.69	17.88%
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	1,416.64	1,676.92	260.28	18.37%
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	1,416.64	1,676.92	260.28	18.37%
4	TATIMI NE BURIM	939.47	1,240.24	300.77	32.01%
	TOTALI	29,749.20	35,215.22	5,466.02	18.37%

C. MALLRA DHE SHERBIME

C	MALLRA DHE SHËRBIME	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Shpenzime për karburant	5,896.73	8,115.35	2,218.62	37.62%
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	3,323.30	3,420.03	96.73	2.91%
3	Shpenzimet për internet	127.12	139.83	12.71	10.00%
4	Shpenzimet e Mirëmbajtjes së Mjeteve	7,200.63	6,659.10	(541.53)	-7.52%
5	Furnizim me Rërë I II III			-	-
6	Shpenzime për Softuer Kompjuterik			-	-
7	Shpenzime për zyre dhe administrative	1,340.68	900.00	(440.68)	-32.87%
8	Shpenzime për pajisje dhe mjete pune	1,030.39	888.98	(141.41)	-13.72%
9	Shpenzime për trajnime			-	-
10	Shpenzimet e Reprerentacionit	357.30	70.00	(287.30)	-80.41%
11	Shpenzimet e Sigurimit			-	-
12	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	248.30	251.70	3.40	1.37%
13	Provizione Bankare NLB BANK	70.20	46.50	(23.70)	-33.76%
14	Çertifikata për shofer kamioni			-	-
15	Çertifikata shëndetsore			-	-
16	Shpenzimet hixhienike	2,395.47	189.07	(2,206.40)	-92.11%
17	Uniforma Pune	694.71	713.14	18.43	2.65%
18	Licence			-	-
19	Shpenzimet e punës në terren	-			
20	Shpenzimet e pazbritshme për qeshtje tatimore	-		-	-
21	Shpenzimet e rrymes	103.67		(103.67)	-100.00%
22	Shpenzimet e ujesjellesit		316.72	316.72	100.00%
	TOTALI	22,788.50	21,710.07	(1,078.43)	-4.73%

D. TOTALI I TE HYRAVE

D.	TE HYRAT	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	67,445.97	70,841.43	3,395.46	5.03%
2	Te hyra tjera (Ministria e Punës)	452.80	1,200.00	747.20	165.02%
	TOTALI	67,898.77	72,041.43	4,142.66	6.10%

E.	TOTALI I SHPENZIMEVE				
1	Totali i shpenzimeve B+C+D	52,537.70	56,925.29	4,387.59	8.35%

F.	FITIMI PARA TATIMIT (D-E)	15,361.07	15,116.14	(244.93)	-1.59%
G.	TATIMI NE FITIM (F*10%)	1,536.11	1,511.61	(24.49)	-1.59%
H.	FITIMI NETO (F-G)	13,824.96	13,604.53	(220.44)	-1.59%

Hani i Elezit
10.04.2026

Zyra e Npl "Pastrimi" Sh.a
Hani i Elezit

A. TË HYRAT

A	TE HYRAT	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	67,445.97	70,841.43	3,395.46	5.03%
2	Te hyra tjera	452.80	1,200.00	747.20	165.02%
	TOTALI	67,898.77	72,041.43	4,142.66	6.10%

B. PAGA DHE MEDITJE

B	PAGAT DHE MEDITJET	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	PAGAT NETO + SHUJTA	25,976.45	30,621.14	4,644.69	17.88%
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	1,416.64	1,676.92	260.28	18.37%
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	1,416.64	1,676.92	260.28	18.37%
4	TATIMI NE BURIM	939.47	1,240.24	300.77	32.01%
	TOTALI	29,749.20	35,215.22	5,466.02	18.37%

C. MALLRA DHE SHERBIME

C	MALLRA DHE SHËRBIME	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Shpenzime për karburant	5,896.73	8,115.35	2,218.62	37.62%
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	3,323.30	3,420.03	96.73	2.91%
3	Shpenzimet për internet	127.12	139.83	12.71	10.00%
4	Shpenzimet e Mirëmbajtjes së Mjeteve	2,200.63	6,659.10	(541.53)	-7.52%
5	Furnizim me Rërë I II III				
6	Shpenzime për Softuer Kompjuterik				
7	Shpenzime për zyre dhe administrative	1,340.68	900.00	(440.68)	-32.87%
8	Shpenzime për pajisje dhe mjete pune	1,030.39	888.98	(141.41)	-13.72%
9	Shpenzime për trajnime				
10	Shpenzimet e Reprerentacionit	357.30	70.00	(287.30)	-80.41%
11	Shpenzimet e Sigurimit				
12	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	248.30	251.70	3.40	1.37%
13	Provizione Bankare NLB BANK	70.20	46.50	(23.70)	-33.76%
14	Certifikata për shofer kamioni				
15	Certifikata shëndetsore				
16	Shpenzimet hiixbienike	2,395.47	189.07	(2,206.40)	-92.11%
17	Uniforma Pune	694.71	713.14	18.43	2.65%
18	Licence				
19	Shpenzimet e punes ne terren				
20	Shpenzimet e pazbritshme për qeshje tatimore				
21	Shpenzimet e kryes	103.67		(103.67)	-100.00%
22	Shpenzimet e njesjellesit		316.72	316.72	100.00%
	TOTALI	22,788.50	21,710.42	(1,078.08)	-4.73%

D. TOTALI I TE HYRAVE

D.	TE HYRAT	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	67,445.97	70,841.43	3,395.46	5.03%
2	Te hyra tjera (Ministria e Punes)	452.80	1,200.00	747.20	165.02%
	TOTALI	67,898.77	72,041.43	4,142.66	6.10%

E. TOTALI I SHPENZIMEVE

1	Totali i shpenzimeve B+C	52,537.70	56,925.64	4,387.94	8.35%
---	--------------------------	-----------	-----------	----------	-------

F.	FITIMI PËR TATIMIN (D-E)	15,361.07	15,115.79	(245.28)	-1.60%
G.	TATIMI NE FITIM (F*10%)	1,536.11	1,511.58	(24.53)	-1.60%
H.	FITIMI NETO (E-G)	13,824.96	13,604.21	(220.75)	-1.60%

Llogaritja e te hyrave dhe shpenzimeve Janar - Mars 2026

A	TE HYRAT	JANAR	SHKURT	MARS	TOTALI
1	Të hyrat nga Shërbimet	27,488.86	21,525.81	21,826.76	70,841.
2	Te Hyra Tjera (Ministria e Punes)	600.00	600.00	-	1,200.
	TOTALI	28,088.86	22,125.81	21,826.76	72,041.

B	SHPENZIMET E KOMPANISË	1	2	3	TOTALI
	PAGAT DHE MEDITJET	JANAR	SHKURT	MARS	TOTALI
1	PAGAT NETO + SHUJTA	9,978.92	9,871.14	10,771.08	30,621.
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	545.08	538.77	593.07	1,676.
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	545.08	538.77	593.07	1,676.
4	TATIMI NE BURIM	377.51	365.54	497.19	1,240.
	TOTALI	11,446.59	11,314.22	12,454.41	35,215.

C	MALLRA DHE SHËRBIME	JANAR	SHKURT	MARS	TOTALI
1	Shpenzime për karburant	2,523.11	2,319.36	3,272.88	8,115
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	1,862.09	1,557.94	-	3,420
3	Shpenzimet për internet	139.83	-	-	139
4	Shpenz. e mirembajtjes se mjeteve dhe objekteve	2,306.90	2,218.05	2,134.15	6,659
5	Furnizim me Rere I II III				
6	Shpenzime për Softwer Kompjuterik				
7	Shpenzime per Zyre dhe administrative	300.00	300.00	300.00	900
8	Shpenzime per pajisje dhe mjete pune		888.98		888
11	Shpenzime per trajnime				
12	Shpenzimet e Reprerentacionit		70.00		70
13	Shpenzimet e Sigurimit				
14	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	83.90	83.90	83.90	251
15	Provizione Bankare NLB BANK	19.10	12.90	14.50	46
16	Çertifikata per shofer kamioni				
17	Çertifikata shendetsore punetor				
18	Shpenzime hixhienike	84.58	104.49		189
19	Uniforma Pune	713.14			713
21	Licenca				
22	Shpenzimet e punes ne terren	-			
23	Shpenzimet e pazbritshme per qeshtje tatimore				
	TOTALI	8,032.65	7,555.62	5,805.43	21,393.

D	Shpenzime Komunale	JANAR	SHKURT	MARS	TOTALI
	Shpenzimet e Rrymes	-	158.49	-	158
	Ujesjellesi			158.23	158
	TOTALI	-	158.49	158.23	316.

E	TOTALI I SHPENZIMEVE (B+C+D+E)	19,479.24	19,028.33	18,418.07	56,921.
---	---------------------------------------	------------------	------------------	------------------	----------------

F	FITIMI PARA TATIMIT (A-E)	8,609.62	3,097.48	3,408.69	15,115
G	T. ne fitim (Tatimi ne te ardhura te korporatave) (F*10%)	860.96	309.75	340.87	1,511
H	FITIMI NETO (F-G)	7,748.66	2,787.73	3,067.82	13,604



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 3684 2026

DATA :	22.04.2026
PËR :	Komiteti për Politikë dhe Financa
PËRMES :	<i>M</i> Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	<i>L Ballazhi</i> Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar Anëtarë/e të Kuvendit Komunal,

Përmes kësaj kërkesë, ju njoftojmë për bilancin e pashpenzuar të të hyrave vetanake të vitit 2025 dhe bartjen e të njejtit në vitin 2026, nëpër kategoritë buxhetore dhe Nën-Programet buxhetore të paraqitura bashkangjitur në shkresë.

Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2025 janë në shumë prej **1,268,412.73 €**, prej tyre janë shpenzuar **707,343.26 €**, kurse për bartje kanë mbetur **561,069.47 €**.

Ndërsa bilanci i pashpenzuar i vitit 2024 i cili u bart në vitin 2025, ishte në shumë prej 170,771.67, prej kësaj shume u shpenzua 151,656.91€, kurse për bartje kanë mbetur 19,114.76 €. Pra në total, të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2025 janë në shumën prej **580,184.23 €** të cilat i bartim në vitin 2026.

Bartja do të realizohet në këto Kategori Buxhetore dhe Nën-Programe Buxhetore, si vijon:

Në kategorinë buxhetore Mallra dhe Shërbime në shumë prej 77,411.96 €, si vijon:

- Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111) shuma prej **10,000.00 €**,
- Zyra e Kuvendit Komunal (16935), kodi funksional (0111), shuma prej **5,000.00 €**,
- Administrata (16335), kodi funksional (0133), në shumë prej **20,000.00 €**,
- Buxhetimi (17535) , kodi funksional (0112), shuma prej **1,911.96 €**,
- Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej **10,000.00 €**,
- Kulturë, Rini dhe Sport (85035),kodi funksional (0820), në shumë prej **10,000.00 €**,
- Administrata (92175), kodi funksional (0980), në shumë prej **10,000.00 €**,
- Arsimi Parafillor- Çerdhja (92890), kodi funksional (0911), shuma prej **5,000.00 €**,
- Arsimi Fillor, i mesëm, i ulët (94020), kodi funksional (0912), shuma prej **3,500.00 €**,
- Arsimi i mesëm i lartë (95220), kodi funksional (0922), në shumë prej **2,000.00 €**,

Në kategorinë buxhetore Shpenzime Komunale në shumë prej 27,023.33 €, si vijon:

- Administrata (16335), kodi funksional (0133), në shumë prej **10,000.00 €**,
- Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej **6,523.33 €**,
- Arsimi Parafillor- Çerdhja (92890), kodi funksional (0911), shuma prej **5,000.00 €**,
- Arsimi Fillor, i mesëm, i ulët (94020), kodi funksional (0912), shuma prej **2,500.00 €**,
- Arsimi i mesëm i lartë (95220), kodi funksional (0922), në shumë prej **3,000.00 €**.

Në kategorinë buxhetore Subvencione dhe Transfere në shumë prej 30,000.00 €, në kuadër të:

- Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111) shuma prej **30,000.00 €**.

Në kategorinë buxhetore Shpenzime Kapitale në shumë prej 445,748.94 në kuadër të:

- **Administrata dhe Personeli (16335):**
Administrata (16335), kodi funksional (0133), në shumë prej **50,000.00 €**,
“Blerja e një automjeti zyrtar”, (i ri), shuma prej **50,000.00 €**.
- **Parandalimi dhe Inspektimi i zjarrit (18444):**
Parandalimi dhe Inspektimi i zjarrit (18444), kodi funksional (0320), në shumë prej **100,000.00 €**, në këto projekte:
“ Ndriçimi publik ne fshatrat: Pustenik, Dimcë, Gorancë, Krivenik, Seçishtë, Rezhancë, Paldenicë, Dermjak” (55033), në shumë prej **100,000.00 €**.
- **Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi (48075):**
Turizmi (48075), kodi funksional (0473), në shumë prej **20,000.00 €**, si vijon:
“Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë”, (55046), në shumë prej **20,000.00 €**.

- **Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480):**
Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej **176,121.00 €**,
“Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenic, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik”, (53471), në shumë prej **12,540.00 €**,
“Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagja e Re dhe në fshatrat Paldenicë, Dermjak, Pustenic, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë” (52894), në shumë **30,694.00€**,
“Rregullimi i varrezave të qytetit dhe fshatrat Gorancë, Pustenic dhe Rezhancë” (55039), në shumë prej **23,890.00 €**,
“Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 - Hani i Elezit” (55037), në shumë prej **10,748.00 €**,
“Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri - Oborri i Komunës, Stadiumi i qytetit - Suad Brava,- Shpronsim”, (56230), në shumë prej **63,249.00 €**,
“Rregullimi i rrugës prej te burimi deri në Lepenc”, (56267), në shumë prej **35,000.00 €**.
- **Kulturë, Rini dhe Sport (85035):**
Kulturë, Rini dhe Sport (85035),kodi funksional (0820), në shumë prej **19,000.00 €**, si vijon:
“Renovimi i sallave sportive në shkollat: SHFMU "Ilaz Thaçi", SHFMU "Veli Ballazhi" dhe SHFMU "Kështjella e Diturisë" (56110), në shumë prej **19,000.00 €**.
- **Arsim dhe Shkencë:**
Administrata (92175), kodi funksional (0980), në shumë prej 80,627.94 € si vijon:
“Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML – Dardania, SHFMU – Ilaz Thaçi, SHFMU – Kështjella e Diturisë dhe SHMFU – Veli Ballazhi dhe IP Ardhmëria (56028), në shumë prej **80,627.94 €**.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/3685 /2026

DATA :	22.04.2026
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi <i>L. Ballazhi</i> Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Kërkesë për futjen e projektit të ri "Blerja e një automjeti zyrtar" në kuadër të Buxhetit për vitin fiskal 2026

**I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar/a Anëtarë/e**

Me anë të kësaj shkrese ju drejtohem për të miratuar kërkesën për blerjen e një automjeti zyrtar për Zyrën e Kryetarit, duke qenë se gjendja faktike e automjetit ekzistues ka filluar të amortizohet. Kjo kërkesë poashtu bazohet edhe në financimin total nga Bartja e Bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026.

Me respekt,